

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQERISE
“ALB SPORT&SERVICES” SH.P.K**

Sot me date 09.11.2021

- **AGATINO PEDICONE**, atesia Giuseppe , shtetas italian, lindur me 13.10.1951, ne Palermo Itali dhe banues ne Palermo, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me karten e identitetit italiane me Nr.AX6899360
- **ADRIATIK MUÇA**, atesia Maksut, shtetas shqiptar, lindur me 02.04.1994 ne Rreshen,Mirdite, Shqiperi dhe banuese ne Fushe Kruje, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me karten e identitetit shqiptare me Nr.J40402076R

bazuar, ne legjislacionin ne fuqi vecanerisht, bazuar ne nenet 68 e vijues te ligjit nr. 9901 dt.14.04.2008 «Per Shoqerite Tregtare» i ndryshuar me ligjin nr. 129/2014 , Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", LIGJ Nr. 131/2015 PER QENDRËN KOMBËTARE TË BIZNESIT, ne dispozitat e Kodit Civil ne cilesine e ortakeve themelues si dhe ne vullnetin tone te lire te shprehur dhe ne nenshkrimin e akteve te themelimit te shoqerise kam hartuar aktin e themelimit dhe statutin e nje Shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar (me poshte shoqeria):

KREU I

THEMELIMI , EMRI, OBJEKTI, KOHEZGJATJA, SELIA

NENI. 1

DATA E THEMELIMIT, EMRI I THEMELUESIT

1. Sot ne date 09.11.2021, u themelua shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emrin

“ALB SPORT&SERVICES” SH.P.K

2. Themeluesit e shoqerise jane:



- **AGATINO PEDICONE**,atesia Giuseppe , shtetas italian, lindur me 13.10.1951, ne Palermo Itali dhe banues ne Palermo, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me karten e identitetit italiane me Nr.AX6899360
- **ADRIATIK MUÇA**, atesia Maksut, shtetas shqiptar, lindur me 02.04.1994 ne Rreshen,Mirdite, Shqiperi dhe banuese ne Fushe Kruje, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me karten e identitetit shqiptare me Nr.J40402076R

NENI. 2

OBJEKTI I SHOQERISE

Objekt i kesaj shoqerie do te jete:

1. Dhenia me qira e makinave,motoreve,minibus,autobus,jahte,mjete lundruese, makina garash etj, si dhe te gjitha llojeve te tjera te mjeteve motorike, personave te trete.



2. Organizimin e kendeve te ndryshme te lojrave, pistave te garimit per efekt argetues te klienteve te saj ne baze te legjislacionit ne fuqi.
3. Promovimin e sportit automobilistik ne Shqiperi me qellim organizimin e garave dhe eventeve te ndryshme sportive kombetare dhe nderkombetare me pjesemarrjen e makinave ne zoterim te Shoqerise ose jo.
4. Tregetim,sherbim me qera,me drejtues mjeti,per çdo mjet te levizshem te lejuar per qarkullim,sherbim taksi,sherbim urban,nderurban,nderkombetar,nderkontinental etj.
5. Transport udhetaresh e mallrash,kombetar e nderkombetar,cargo etj.
6. Kryerjen e sherbimeve,servisin etj, per riparimin e mjeteve motorike te te gjitha markave te shitura ose jo prej Shoqerise.
7. Krijimi i Agjensive Turistike,organizimi i guidave turistike brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise.
8. Agjensi transporti ndërkombëtare udhëtarësh.
9. Shitje dhe blerje automjetesh.
10. Shoqeria ka si objekt veprimtarie organizimin e eventeve te ndryshme, artistike, komerciale apo te cdo lloj forme tjeter, si per shembull, por pa u limituar ne: koncerte, reklamime, fushata publicitare,marredhenie me publikun, ekspozita, festivale, evente tregtare, shfaqje etj.
11. Cdo operacion tregtar, operacione qe lidhen me pasurite e luajtshme dhe te paluajtshme dhe hipotekore qe lidhen me to, operacione financiare dhe kredimarrje, te jape garanci te treteve si edhe te bleje dhe shese ose marre me qera ndermarrje, dege ndermarrjesh, si edhe te kete pjesemarrje ne shoqeri, ente, konsorciume, te themeluara apo ne themelim e siper, qe kane objekt te njejte ose te ngjashem me te vetin apo gjithsesi funksional per arritjen e qellimeve te shoqerise.
12. Konsulence te pergjithshme.
13. Blerje , shitje, dhenie me qera te autoveturave
14. Tregtim me shumice dhe pakice, Import-eksport te produkteve te ndryshme te cfaredo kategorie,materialeve te ndertimit dhe makinerive te ndryshme te domosdoshme per ushtrimin e aktivitetit perfshire produktet bujqesore dhe ushqimore ne teresi .
15. Ushtrimi i aktivitetit brenda dhe jashte Shqiperise, ne perputhje me legjislacionin.
16. Cdo aktivitet tjeter te lidhur me aktivitetin kryesor

Per te gjitha aktivitetet qe kerkojne licenca te vecanta shoqeria do te angazhohet qe tani per te plotesuar kerkesat e ligjeve te posacme.

NENI. 3 KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e shoqerise do te jete deri ne nje afat te papercaktuar
Shoqeria mund te priset perpara ketij afati me vendim te asamblese se Ortakeve.

NENI. 4 SELIA E SHOQERISE

Selia e Shoqerise .eshte ne adresen: Bulevardi Deshmoret e Kombit, Qendra e Biznesit
“Kullat Binjake” kati 2, nr. 26 Tirane.

KREU II KAPITALI




NENI. 5

KAPITALI I REGJISTRUAR

Kapitali i regjistruar i shoqerise do te jete 100.000 (njqindmije) leke i perbere nga dy(2) kuota.

Pjesemarrja e ortakut themelues ne kapitalin e shoqerise eshte:

Kontributi ne kapitalin e shoqerise zoterohet nga Ortaket ne masen :

- ***AGATINO PEDICONE, atesia Giuseppe , shtetas italian, lindur me 13.10.1951, ne Palermo Itali dhe banues ne Palermo, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me karten e identitetit italiane me Nr.AX6899360 zoteron 51% te kuotave me vlere te kuotave prej 51.000 lekesh.***
- ***ADRIATIK MUÇA, atesia Maksut, shtetas shqiptar, lindur me 02.04.1994 ne Rreshen, Mirdite, Shqiperi dhe banuese ne Fushe Kruje, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me karten e identitetit shqiptare me Nr.J40402076R zoteron 49% te kuotave prej 49.000 lekesh.***

Kontributi i ortakut mund te jete ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme/te paluajtshme, apo te drejta).

NENI. 6

ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve te kapitalit te regjistruar per kontribute ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute.

Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin e regjistruar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohet per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi prek ne te njejtën mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqsojne.


NENI. 7

TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo te kalohen si me poshte:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Cdo menyre tjeter percaktuar ne ligj.

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme midis ortakeve.



Pjeset e kapitalit te regjistruar jane te transferueshme me rruge trashegimije, sipas parashikimeve ligjore.

KREU III
ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE
NENI. 8

ORGANET VENDIMARRESE

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmares i shoqerise.

Asambleja e pergjithshme eshte kompetente per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet si me poshte:

- a. Percaktimi i politikave tregtare te shoqerise
- b. Ndryshimet e statutit
- c. Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- d. Emerimin dhe shkarkimin e likujdatoreve dhe eksperteve kontabel te autorizuar
- e. Percaktimi i shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c) e d)
- f. Mbikqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret perfshire per gatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise
- g. Miratimi,i bilanceve
- h. Zmadhim dhe zvogelim kapitali
- i. Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- j. Perfaqesimin ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve
- k. Riorganizimi dhe prishja e shoqerise
- l. Miraton rregulla proceduriale te mbledhjeve te asamblese
- m. Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete. Administratori i shoqerise nuk mund te veproje si perfaqesues i ortakeve ne asamblene e pergjithshme. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

NENI 9

THIRRJA E MBLEDHJES SE ASAMBLESE SE PERGJITHSHME

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithë ortakeve, jo me vonë se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese


Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë ortakët jane dakort, per te marre vendime, pavaresisht parregullise.

NENI 10

KUORUMI

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese marrin pjese ortakët, qe zoterojne me shume se 30 % te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per tregtaret dhe Shoqerite tregtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese ortakët qe zoterojne me shume se gjysmen e



numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese kuorumi i permendur ne paragrafin e mesiperm nuk arrihet, asambleja e pergjithshme, mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

NENI 11

MARRJA E VENDIMEVE

Asambleja e pergjithshme vendos me $\frac{3}{4}$ e votave te zoteruesve te kapitalit te ortakeve pjesmarres, per ndryshimin e statusit zmadhimin ose zvoglimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizmin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesmarres, per ceshtjen te tjera.

Cdo ndryshim duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne regjistrin e shoqerise.

NENI 12

PERJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTES

Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendimin pet:

- a) vleresmin e veprimtarise se tij
- b) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij
- c) ngritjen e nje padije ndaj tij nga shoqeria
- d) dhenien ose jo te perfitimeve te reja

Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konfikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

NENI 13

ADMINISTRIMI

Asambleja e pergjithshme emeron nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet me te drejte ripertesitje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne QKB.

Personi i meposhtem caktohet si Administrator i pare i shoqerise, duke patur te drejta te pakufizuara administrimi:


- ***AGATINO PEDICONE, atesia Giuseppe shtetas italian, lindur me 13.10.1951, ne Palermo Itali dhe banues ne Palermo, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i identifikuar me karten e identitetit italiane me Nr.AX6899360***

NENI 14

KOMPETENCAT E ADMINISTRATOREVE

Administratoret kane te drejte dhe detyrohen te:

- a) Kryejne te gjitha veprimet e administrimit te vendosura nga asambleja e pergjithshme duke zbatuar politikat tregetare
- b) Perfaqesojne shoqerine



- c) Kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoqerise
- d) Pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe
- e) Raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, I paraqesin keto dokumente perpara Asamblese se Pergjithshme per miratim
- e) Krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise
- f) Kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhena e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit
- g) Raportojne para Asamblese se Pergjithshme nepermjet relacioneve mbi zbatimin e politikave tregtare dhe te veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise
- h) Kryejne detyra te tjera te parashikuara nga ligji dhe statuti.

Asambleja e pergjithshme mundet ne cdo moment, te shkarkoje administratorin me shumice te thjeshte te votave. Statuti ose rregullore te tjera nuk mund ta kufizojne ose heqin kete te drejte.

NENI 15

PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT

1. Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate admInstrImIt te shoqerise. Administratoret te cilet kane kryer veprIme ose bere marreveshje te pa aprovuara nga asambleja, jane pergjegjes per demet e sjella shoqerise dhe pergjigjen personalisht ose solidarisht per pasojat.
2. Nese administratori vepron ne kundersiztim me detyrat dhe shkel standartet profesionale eshte i detyruar ti demshperbleje shoqerise demet qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes si dhe ti kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregulta.

KREU IV

VITI FINANCIAR -EKSPERTET

NENI 16

VITI FINANCIAR

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 janar dhe perfundon ne 31 Dhjetor, Perjashtimisht , viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB dhe mbyllet me 31 dhjetor

NENI 17

EKSPERTET

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjitha dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko-tregtare te shoqerise, dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij, per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve. Ne permbushje te kesaj detyre eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe ate per kontrollet periodike te ushtruara.

KREU 5




PRISHJA DHE RI-ORGANIZIMI I SHOQERISE

NENI 18

PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

Shoqeria konsiderohet e shperndare kur:

- a. Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar e shoqerise
- b. Me vendimet e asamblese se Ortakeve
- c. Me hapjen e procedurave te falimentit
- d. Nese nuk zhvillon aktivitetet tregetar per 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 Per Qendren Kombetare te Regjistrimit,
- e. Me vendim gjykate.

NENI 19

RIORGANIZIMI I SHOQERISE

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te ligjit mbi shoqerite tregtare.

ART. 20

KLAUZOLA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT

Ortaket dhe administratoret e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar, nuk mund te mbajne pozicionin drejtues apo te jene te punesuar ne nje shoqeri qe ushtron aktivitet ne te njejten fushe me te paren. Ndalimi i pikes 1 mund te anulohet ne asamblene e pare te pergjithshme me ³/₄ e votave ne sipas dispozitave te neneve 87 dhe 145 te ligjit per shoqerite tregtare.

NENI 21

LEGJISLACIONI

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me statutin, legjislacionin shqiptar dhe ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

NENI 22

MOSMARRREVESHJET

Per mosmarrveshjet midis ortakeve te shoqerise, ose shoqerise me te tretet, gjykata kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata Shqiptare.

Ky akt, u redaktua ne 4 kopje ne gjuhen shqipe dhe ne gjuhen italjane, me vlere te njejte ligjore.

ORTAKET THEMELUES

AGATINO PEDICONE

AGATINO PEDICONE



ADRIATIK MUÇA



ADRIATIK MUÇA